

VENDIM
Nr. 301, datë 23.5.2018

PËR PROCEDURËN E FALJES SË DETYRIMEVE PËR SUBJEKTET E LIGJIT NR. 72/2017, “PËR FALJEN E DETYRIMEVE NDAJ FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PERSONAVE NË PENSION INVALIDITETI, SIPAS LIGJIT NR. 7703, DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE TË PERSONAVE NË PENSION, SIPAS LIGJIT NR. 150/2014, “PËR PENSIONET E PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË”, TË KRIJUARA PËR SHKAK TË PUNËSIMIT GJATË KOHËS SË PËRFITIMIT TË PENSIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 3, të ligjit nr. 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ngarkojë Institutin e Sigurimeve Shoqërore që, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi:

a) të evidentojë në kartelë të veçantë financiare dhe të çregjistrojë në kontabilitet shumën e detyrimit të mbetur më 31.12.2016 të çdo pensionisti në pension invaliditeti apo si ish-punonjës nëntoke, e cila falet sipas përcaktimeve në nenet 1 e 2, të ligjit nr. 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

b) të evidentojë në kartelë të veçantë financiare shumat që pensionistët debitorë kanë paguar në periudhën nga 1.1.2017 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 72/2017, të cilat i përkasin likuidimit të detyrimeve të krijuara deri në datën 1.1.2017, të cilat janë falur, sipas dispozitave të ligjit nr. 72/2017, dhe të bëjë kthimin e tyre për llogari të çdo përfituesi.

2. Falja dhe kthimi i shumave të detyrimit të falur, por të paguara, sipas përcaktimeve në shkronjat “a” e “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, bëhet me vendim të nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe jepet evidentim apo pagesë në sistemin informatik të përfitimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Rregullshmëria e vendimeve të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore lidhur me evidentimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të ligjit nr. 72/2017, si dhe të shumave të detyrimeve të paguara për t’u kthyer, të jetë objekt i veçantë auditimi nga audit i brendshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Rezultatet e auditimit t’i njoftohen ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

4. Efektet financiare, në shumën 9 352 000 (nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, të nevojshme për kthimin e shumave të detyrimeve të paguara nga përfituesit për periudhën janar–maj 2017, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore të vitit 2018.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama